



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 04.06.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 03.06.2026, të parashtruar nga Operatori ekonomik "BIO-LAB" SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me inventar dhe pajisje mjekësore", Nr. i prokurimit- 632-26-3635-1-1-1, Nr. i brendshëm-632-26-020-111, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik "BIO-LAB" sh.p.k., e dt.03.06.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me inventar dhe pajisje mjekësore", Nr. i prokurimit- 632-26-3635-1-1-1, Nr. i brendshëm-632-26-020-111, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të datës 19.05.2026, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. Vërtetohet** DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të publikuar me datë: **19.05.2026;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

A r s y e t i m

Operatori ekonomik "BIO-LAB" sh.p.k. me dt.03.06.2026, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me inventar dhe pajisje mjekësore", Nr. i prokurimit- 632-26-3635-1-1-1, Nr. i brendshëm-632-26-020-111.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 04.06.2026, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Në kërkesën për rishqyrtim, ju nuk keni arritur të argumentoni dhe as të provoni se Autoriteti Kontraktues ka shkelur ndonjë dispozitë të Ligjit për Prokurimin Publik. Përkundrazi, ju jeni mjaftuar vetëm me citimin e disa dispozitave ligjore, pa specifikuar dhe argumentuar se cilat veprime konkrete të Autoritetit Kontraktues përbëjnë shkelje të këtyre dispozitave.

Po ashtu, kërkesa për rishqyrtim nuk përmban një deklaratë të qartë dhe të detajuar mbi faktet dhe argumentet që mbështesin pretendimet për shkelje të dispozitave të LPP-së. Ju nuk keni paraqitur faktet konkrete, provat dhe argumentimin e nevojshëm që do të mbështesnin secilën bazë të kërkesës për rishqyrtim.

Në këtë rast, kërkesa nuk i plotëson kërkesat formale të përcaktuara në nenin 60.3, shkronjat **f)** dhe **h)** të **Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik**, të cilat obligojnë operatorin ekonomik që në kërkesën për rishqyrtim të paraqesë:

- deklaratë të detajuar mbi faktet dhe argumentet që përbëjnë bazën e pretendimit për shkelje të dispozitave të LPP-së; dhe
- deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet që mbështesin secilën bazë të kërkesës për rishqyrtim.

Duke qenë se ju nuk keni përmbushur këto kërkesa dhe nuk keni dëshmuar ekzistimin e ndonjë shkeljeje nga ana e Autoritetit Kontraktues, kërkesa për rishqyrtim refuzohet si e pabazuar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

